



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 99/2013
Prishtinë, më 26.3.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha – Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Mungoi: Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Kamerolli, Hasan Ibraj dhe Nazmi Gashi –MI; Ukë Gashi- ZPRK; Burim Ejupi dhe Darsei Canhasi – INDEP; Nora Jusufi- KDI dhe Gurjeta Zeka – praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 19.3.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-179 për transportin rrugor;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.3.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 19.3.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-179 për transportin rrugor

Kryetari – Tha se grupi punues ka pas disa takime, për Projektligjin për transportin rrugor dhe ka hartuar disa amendamente, të cilat ne, sot do t'i diskutojmë në këtë mbledhje të komisionit. Kryesuese e grupit punues është znj. Teuta Sahatqija, por më qenë se ajo për momentin ende nuk ka ardhur, fjalën po ia kalojmë z. Lutfi Zharkut, për t'i prezantuar amendamentet.

Lutfi Zharku - Tha që grupi punës i ka mbajtur 6 takime, po ashtu ka mbajtur edhe dëgjim publik. Në takime kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit Ministrisë së Infrastrukturës, si sponsorues të projektligjit. Ai theksoi se grupi i punës gjatë shqyrtimit, i ka nxjerrë 114 amendamente dhe më pas bëri prezantimin e amendamenteve një nga një.

Vërejtjet në projektligj dhe amendamente:

Pas debatit të deputetëve Ramiz Kelmendi, Visar Ymeri dhe Hashim Dëshishku, u miratuan këto amendamente:

Amendamenti 1, 4, 5, 14 dhe 15, u përmirësuan teknikisht, ndërsa u miratuan amendamente të reja si në vijim:

Amendamenti 8

Neni 3, nënparagrafi 1.53, ndryshohet si vijon:

1.53. “Ngasës” - personi që ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e automjetit transportues;

Amendamenti 16

Neni 7, nënparagrafi 2.3, ndryshohet si vijon:

2.3. Transport ndërkombëtar të mallrave;

Amendamenti 19

Neni 8 fshihet.

Amendamenti 20

Neni 10, ndryshohet si vijon:

1. Për marrjen e licencës të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, operatori duhet t'i plotësojë këto kushte:

1.1. Të jetë i regjistruar (themeluar) në Kosovë;

1.2. Të ketë reputacion të mirë;

1.3. Të ketë kapacitete të përshtatshme / të qëndrueshme financiare, të cilën e vërteton në bazë të pronësisë mbi mjetet apo garancitë financiare/bankare;

1.4. Të ketë kompetencën e nevojshme profesionale për menaxher transporti;

1.5. Të ketë në gjendje të mire teknike-ekspluatuese automjetin e transportit;

2. Për marrjen e licencës të stacionit të autobusëve dhe terminaleve të mallrave, operatori duhet t'i plotësojë këto kushte:

- 2.1. Të jetë i regjistruar (themeluar) në Kosovë;
- 2.2. Të ketë reputacion të mirë;
- 2.3. Të ketë kapacitete të përshtatshme / të qëndrueshme financiare, të cilën e vërteton në bazë të pronësisë mbi mjetet apo garancitë financiare/bankare;
- 2.4. Të ketë kompetencën e nevojshme profesionale për menaxher transporti;

Shaip Muja – Kërkoi që edhe një herë të mblidhet grupi punues, bashkë me përfaqësuesit e MI-së sepse në këtë mënyrë të diskutimit, për çdo amendament, nuk mund të përfundohet sot mbledhja, përveç nëse dy ose tri çështje që mbasin të hapura, mund t'i diskutojmë në mbledhje të Komisionit.

Hashim Deshishku – Tha se deri më tani kemi ardhur te amendamenti 18, dhe kërkoi nga përfaqësuesit e ministrisë, që për çdo amendament të mos bëjnë komente, por të japim sqarime sepse kanë qenë vazhdimisht në mbledhje të grupit punues dhe aty është dashur ti japin komentet e jo tani.

Teuta Sahatqija - Tha së është njëri prej Projektligjeve që kemi diskutuar më së shumti në mbledhje të grupit punues, por që ende po shihet që kanë mbetur shumë çështje të hapura.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Propozim-amendamenteve të Projektligjit Nr. 04/L-179 për transportin rrugor për një mbledhje tjetër.

6. Të ndryshme

Çështje vijuese

Shaip Muja – Ngriti çështjen e karburanteve të naftës, për cilësinë e tyre që po diskutohet edhe nëpër mediume. Por tha, që edhe Bashkim Evropian ka paraqitur vërejtje për cilësinë e dobët të karburanteve të naftës. Propozoj, që të shqyrtohet mundësia e nismës ligjore qoftë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ose nga Komisioni për hartimin e Projektligjit për prodhimin, transportin dhe tregtimin biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, që të rregullohet ky sektor, pasi që edhe BE-ja e ka në program çështjen e trajtimit të sulfurit. Ai theksoi së si model mund ta marrim Ligjin nga Shqipëria, që trajton këtë fushë në mënyrë shumë të mirë dhe të saktë.

Teuta Sahatqija - Theksoi që këto dy çështje që u ngritën nga z. Muja, kanë nevojë që të kenë një trajtim të nevojshëm dhe të shikojmë procedurat se si i shqyrtojmë në Komision.

Lutfi Zharku - Tha së për cilësinë e naftës është Ligji përkatës i naftës, por vetëm që duhet të zbatohet dhe mos të shkelen procedurat që parasheh ligji, siç është inspektorati, që më anë të laboratorëve bënë inspektimin e cilësisë së derivateve të naftës.

Visar Ymeri – Theksoj së pajtohet së të dy çështjet e ngritura që janë të rëndësishme, për cilësinë e naftës mund t'i ftojme përfaqësuesit MTI-së për të na informuar. Ndërsa, për nismën ligjore që e rregullon fushën e biokarburanteve, propozoi që të organizohet një tryeze e pastaj të shohim ne si Komision se çka mund të bëjmë dhe sa kemi kapacitet dhe ku duhet kërkuar ekspertizë për hartimin këtij Projektligji.

Sala Berisha-Shala - Tha se pajtohet plotësisht me dy propozimet e z. Muja, që ta ftojme ministren MTI-së për raportim në Komision. Dhe të fillojmë me procedurat për nismë ligjore,

pasi që Komisioni edhe në vitin e kaluar e ka pas një nisme ligjore dhe e ka përfunduar me sukses hartimin e Projektligjit për Miniera dhe Minerale.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori

Përfundim

Të ftohet znj. Mimoza Kusari – Lila, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, për të raportuar para Komisionit në seance dëgjimore, për cilësinë e karburanteve të naftës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit